



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 66, DATË 21.08.2020

PËR
ZGJERIMIN E ZONËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË SHOQËRISË
“MAQELLARA TV KABLLOR” SH.P.K., AUTORIZUAR PËR PËRSËRITJEN E
SHËRBIMIT TË PROGRAMIT AUDIOVIZIV TË TË TRETËVE MBËSHTETUR NË
RRJET KABLLOR “TV KABLLOR MAQELLARA”

Në mbështetje të nenit 19, pika 1/b, nenit 55, pika 4/b të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe rregullores “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së autorizimeve”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 99, datë 07.06.2017, si dhe pas shqyrtimit të aplikimit nr. 1848 prot., datë 07.07.2020, të shoqërisë “Maqellara Tv Kabllor” sh.p.k., për zgjerimin e zonës së shërbimit, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Maqellara Tv Kabllor” sh.p.k., me administratorë: Zj. Arbina Capa dhe Z. Irfan Nasufi dhe NIPT: K86820701U, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Maqellara”, në “*Njësinë administrative Gjoricë*”.
2. Zona e ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Maqellara Tv Kabllor” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Maqellara”, bëhet: “*Njësitë administrative Maqellarë dhe Gjoricë*”.
3. Kushtet e autorizimit të shoqërisë “Maqellara Tv Kabllor” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Tv Kabllor Maqellara”, përveç zonës së ofrimit të shërbimit, mbeten të pandryshuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:	Gentian	SALA
Zëvendëskryetar:	Sami	NEZAJ
Anëtarë:	Agron	GJEKMARKAJ
	Gledis	GJIPALI
	Suela	MUSTA